



AGJENCIA PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 e Ligjit për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 72/2007, 5/2009, 43/2014, 193/2015 dhe 39/2016), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural publikon në vijim

THIRRJE PUBLIKE Nr. 10/2016

Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare në zhvillim rural për vitin 2016

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Kod i masës	Emri i masës	Shpenzimet e pranueshme
3	Subvencionim të normës së interesit	Ndihmë në shumë prej 50% të normës së interesit në nivel vjetor për periudhë deri në 10 vjet

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Masa
Shfrytëzues të ndihmës për subvencionim të normës së interesit janë personat fizikë dhe juridikë përdorues të mjeteve financiare nga instrumenti ndihma paraqasëse në bujqësi dhe zhvillimin rural nga Bashkimi Evropian.	Masa 3

III. LARTËSIA E MBËSHETJES FINANCIARE

Ndihma është e hartuar për kredi që kanë normë vjetore të interesit prej deri në 8% në vit, të cilat janë të plasuar nga banka dhe kursimet me leje pune nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë për periudhë prej 10 vjet dhe atë për investime të cilat janë të financuara nga instrumenti ndihma paraqasëse në bujqësi dhe zhvillimin rural nga Bashkimi Evropian dhe të njëjtat nuk janë më të larta se 500,000 euro në denarë me normën mesatare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë të vendosur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë.

Ndihma arrin në 50% të normës së interesit në vit. Shuma e ndihmës mund të jetë edhe më e lartë se 50% në përputhje me nenin 94 paragrafi (2) nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

III. KUSHTET E PËRDORIMIT TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I DORËZUAR

Kërkesat dorëzohen në formë elektronike, pas regjistrimit në: e-baranje.ipardpa.gov.mk

Një kërkesë mund të dorëzohet vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti 2 kërkesa të veçanta me masa të ndryshme duke i marr parasysh edhe masat e mbetura nga Programi i mbështetjes financiare për zhvillim rural për vitin 2016.

Kushtet që duhet të plotësojnë kërkuessit përcaktohen nga:

- Programi i mbështetjes financiare për zhvillim rural për vitin 2016 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2016, 64/2016, 176/2016 dhe 190/2016)
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011,126/2012...163/2016)
 - Rregullorja për zbatimin të subvencionimit të normës së interesit për bujqësi dhe zhvillim rural („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 177/2016)

Kërkuessit e përkrahjes financiare duhet të krijojnë kërkesë elektronike për mbështetje financiare më të dhëna të nevojshme dhe obligueshëm të shtojnë dokumentet në formë elektronike (1) Marrëveshje të nënshkruar me bankën apo kursimoret për investimi i financuar nga instrumenti për ndihmë paraqasëse në bujqësi dhe zhvillimin rural nga Bashkimi Evropian dhe (2) Plani i detajuar i shlyerjes i cili është i bashkangjitur në marrëveshjen e kredisë)

- Kërkesat të cilat i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masën 3 do të renditet në përputhje me datën dhe orën e dorëzimit të kërkesës elektronike në: e-baranje.ipardpa.gov.mk

- Kërkesat që nuk janë dorëzuar në mënyrë elektronike nuk do të merren parasysh.

III. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIME

Udhëzimi për regjistrim të kërkuessve në sistemin për dorëzim elektronik të kërkesës mund të merret në faqen kryesore e-baranje.ipardpa.gov.mk.

Udhëzimi për shfrytëzuesit për masë të veçantë mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën.

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,

Rr. Brigada e 3 e Maqedonisë nr. 20 (Ndërtesa e Maqedonisë Tabak blok)
1000 Shkup

III. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesë e plotësuar në formë elektronike për mbështetje financiare duhet të merret, të shtypet dhe të nënshkruhet dhe bashkë me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohet deri te Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në zarf të mbyllur në anën e majtë sipërme qëndron Kërkesë për përkrahje financiare dhe Numri i Arkivit të kërkesës (1016-30016-XXXX/1). Kërkesa mund të dorëzohet me postë ose personalisht në arkivin e Agjencisë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 25.12.2016. Për më shumë informacion kontaktoni në nr. (02) 3097-460 ose e-mail adresën:

e-baranje@ipardpa.gov.mk ose ueb faqen:

www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e projekteve Telefon 02 3097 - 460, @do ditë pune nga ora 08.30 deri 16.30



AGJENCIA PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL